



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 31 gusht 2021

Njoftim për shtyp

Zhvillimet më të rëndësishme në bilancin e pagesave¹ në tremujorin e dytë të vitit 2021

Në tremujorin e dytë të vitit 2021, në transaksionet rrjedhëse me jorezidentë, është realizuar deficit prej 120 milionë euro, kryesisht si rezultat i deficitit në shkëmbimin e mallrave. Tek transaksionet financiare me jorezidentë, janë realizuar hyrje neto nga investimet direkte dhe huatë, dhe dalje neto nga valutat dhe depozitat, kreditë tregtare dhe portfolio investimet. Në tremujorin e dytë rezervat valutore u rritën për 94,5 milionë euro.

Komponentët elementar të bilancit të pagesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut

(në milionë euro)

	тековна година			претходна година			квартална промена		годишна промена		збирна промена	
	Кв.1.2021	Кв.2.2021	Кв.1-Кв.2 2021	Кв.1 2020	Кв.2 2020	Кв.1-Кв.2. 2020	милиони евра	%	милиони евра	%	милиони евра	%
Тековна сметка	-54.7	-120.0	-174.7	-156.1	-91.9	-247.9	-65.3	...*	-28.2	30.6	73.2	-29.5
Стоки	-505.2	-563.0	-1,068.1	-546.3	-352.4	-898.7	-57.8	11.4	-210.6	59.8	-169.4	18.9
Услуги	193.4	129.8	323.2	164.8	105.0	269.8	-63.6	-32.9	24.8	23.6	53.4	19.8
Примарен доход	-127.2	-133.7	-261.0	-100.4	-99.1	-199.4	-6.5	5.1	-34.7	35.0	-61.5	30.9
Секундарен доход	384.3	446.9	831.2	325.8	254.6	580.4	62.6	16.3	192.3	75.5	250.8	43.2
Капитална сметка	-3.7	2.8	-0.9	0.3	4.3	4.5	6.5		-1.5		-5.4	
Финансиска сметка	-27.8	-69.1	-96.9	-170.6	-70.9	-241.6	-41.4		1.8		144.7	
Директни инвестиции	13.9	-204.0	-190.1	-135.9	6.7	-129.1	-217.9		-210.7		-61.0	
Нето-стекнување средства	331.4	5.5	336.9	106.1	-12.8	93.3	-325.9		18.3		243.6	
<i>Сопственички капитал**</i>	45.9	2.4	48.4	5.3	6.6	11.9	-43.5		-4.2		36.5	
<i>Реинвестирање на добивка</i>	1.7	2.1	3.8	3.2	2.5	5.7	0.4		-0.4		-1.9	
<i>Должнички инструменти</i>	283.7	1.0	284.7	97.6	-21.9	75.8	-282.7		22.9		209.0	
Нето-создавање обврски	317.5	209.5	527.0	242.0	-19.5	222.5	-108.0		229.0		304.6	
<i>Сопственички капитал**</i>	33.9	30.8	64.7	20.6	48.3	68.9	-3.1		-17.5		-4.2	
<i>Реинвестирање на добивка</i>	95.5	75.1	170.5	86.3	28.5	114.8	-20.4		46.6		55.7	
<i>Должнички инструменти</i>	188.2	103.7	291.8	135.1	-96.4	38.8	-84.5		200.0		253.0	
Портфолио-инвестиции	-636.9	8.6	-628.3	31.6	-632.5	-600.9	645.5		641.1		-27.5	
Валуту и депозити	27.6	120.2	147.8	71.8	130.5	202.4	92.6		-10.3		-54.6	
Заеми	-18.5	-145.4	-163.9	113.0	-166.7	-53.7	-126.9		21.3		-110.2	
Трговски кредити	-26.4	56.9	30.5	-1.9	-13.2	-15.0	83.3		70.1		45.5	
Девизни резерви	611.5	94.5	706.1	-249.3	604.0	354.7	-517.0		-509.5		351.3	

...* процентуалната промена е над 100

** Сопственички капитал, освен реинвестирањето на добивката

Shënim: Në llogarinë financiare shenja (-) tregon hyrjet netonga vendet e huaja. Tek rezervat valutore shenja (+) tregon rritje, ndërsa shenja (-) tregon zvogëlim të rezervave valutore. Ndryshimet e çmimeve dhe diferencat në kursin e këmbimit janë përjashtuar nga të dhënat për rezervat valutore. Burimi: BPRMV.

¹ Bilanci i pagesave është një raport statistikor që përmbledh sistematikisht të gjitha transaksionet ekonomike të Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendet e huaja për një periudhë të caktuar kohore, gjegjësisht i përmbledh transaksionet rrjedhëse, kapitale dhe financiare ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve..




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Llogaria rrjedhëse


Në tremujorin e dytë të vitit, në transaksionet rrjedhëse me jorezidentë, është regjistruar deficit në shkëmbimin e mallrave (563 milionë euro) dhe në të ardhurat parësore (133,7 milionë euro), i cili i tejkaloi hyrjet neto në të ardhurat dytësore dhe në shkëmbimin e shërbimeve (446,9 dhe 129,8 milionë euro, përkatësisht).

Në bazë tremujore, deficitin e llogarisë rrjedhëse është rritur për 65,3 milionë euro. Ky ndryshim kryesisht është rezultat i hyrjeve neto të zvogëluara tek nënbalanci i shërbimeve për (63 milionë euro) dhe rritja e hyrjeve neto në shkëmbimin e mallrave dhe të ardhurat parësore (për 57,8 dhe 6,5 milionë euro), në kushte të hyrjeve neto të rritura në të ardhurat dytësore (për 62,6 milionë euro).

Krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar, deficitin e llogarisë rrjedhëse është zmadhuar për 28,2 milionë euro, si rezultat i rritjes së deficitit në shkëmbimin e mallrave dhe të ardhurat parësore (për 210,6 dhe 34,7 milionë euro) në kushte të suficitit të rritur në të ardhurat sekundare (për 192,3 milionë euro) dhe në shkëmbimin e shërbimeve (prej 24,8 milionë euro).



Burimi: BPRMV.





Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Llogaria financiare

Transaksionet financiare me jorezidentët, në tremujorin e dytë të vitit 2021 shënuan hyrje neto prej 69,1 milionë eurosh. Analizuar sipas kategorive, hyrje neto shënuan investimet direkte (204 milionë euro) dhe huatë (145,4 milionë euro), ndërsa dalje neto u shënuan tek valutat dhe depozitat (120,2 milionë euro), kreditë tregtare (56,9 milionë euro) dhe portfolio investimet (8,6 milionë euro). Rezervat valutore shënuan rritje për 94,5 milionë euro.

Hyrjet neto të realizuara në investimet direkte prej 204 milionë euro janë rezultat i hyrjeve neto në të gjitha nënkomponentët, edhe atë: tek huatë ndërkompani (102,7 milionë euro), riinvestimi i fitimit (73 milionë euro) dhe kapitali (28,4 milionë euro).

Detyrimet në bazë të investimeve direkte² shënojnë një rritje prej 209,7 milionë euro në tremujorin e dytë, si rezultat i detyrimeve të rritura të huave ndërkompani (103,7 milionë euro), riinvestimi i fitimit (75,1 milionë euro) dhe kapitalit (30,8 milionë euro).

Mjetet nga investimet direkte shënuan rritje prej 5,5 milionë euro, si rezultat i rritjes së huave nga kapitali (prej 2,4 milionë euro), riinvestim i fitimit (prej 2,1 milionë euro) dhe huave ndërkompani (1 milion euro).

Në tremujorin e dytë detyrimet neto në bazë të portfolio investimeve janë zvogëluar për 8,6 milionë euro, kryesisht si rezultat i rritjes së huave nga investimet e rezidentëve në letra me vlerë të huaja vetanake.

Këtë tremujor, hyrjet neto në bazë të huave prej 145,5 milionë euro kryesisht janë rezultat i hyrjeve neto nga aktivitetet specifike të bankës qendrore lidhur me menaxhimin e rezervave valutore (prej 75,4 milionë euro) dhe hyrjeve neto nga sektori "shtet" (66,5 milionë euro). Ndikim të njëjtë kanë edhe sektorët tjerë³, me hyrje neto të realizuara prej 25,4 milionë euro, përballë sektorit "institucione tjera valutore" ku u shënuan dalje neto prej 21,8 milionë euro.

Në gjysmën e parë të vitit, hyrjet neto nga portfolio investimet (628,3 milionë euro), investimet direkte (190,1 milionë euro) dhe huatë (163,9 milionë euro) tejkalojnë daljet neto të bazuara në valuta dhe depozita (147,8 milionë euro) dhe kredi tregtare (30,5 milionë euro), e cila mundësoi financimin e plotë të deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe rritje të rezervave valutore për 706,1 milionë euro.

Sipas strukturës së investimeve direkte në gjysmën e parë të vitit, hyrjet neto prej 190,1 milionë euro janë kryesisht rezultat i fitimit të riinvestuar (166,7 milionë euro), të plotësuar me hyrjet neto nga investimet në kapital (16,3 milionë euro) dhe borxhi ndërkompani (7,1 milionë euro).

² Paraqiten investime direkte në varësi të faktit nëse transaksionet financiare krijojnë detyrim ndaj ose të arkëtueshme (aktive) nga vendet e huaja.

³ Sektorët tjerë përfshijnë: institucione tjera financiare, ndërmarrje jofinanciare, amvisëri dhe institucione jofitimprurëse të cilat i shërbejnë amvisëritë.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë



Burimi: BPRMV.


Rishikimi i të dhënave

Të dhënat për bilancin e pagesave në këtë njoftim përmbajnë rishikim të rregullt të të dhënave për periudhën janar-mars të vitit 2021 me qëllim të përmirësimit të kualitetit të tyre.

Më tej, në llogarinë rrjedhëse rishikimi i të dhënave ndikoi në zvogëlimin e deficitit për 6,5 milionë euro, kryesisht si rezultat i rishikimit të nënbilancit të shërbimeve.

Sa i përket llogarisë financiare rishikimi ndikoi në zvogëlimin e daljeve neto tek investimet direkte për 12 milionë euro dhe zvogëlimin e hyrjeve neto tek huatë tregtare për 13,1 milionë euro dhe tek huatë për 2,1 milionë euro.

Rishikimi i të dhënave ndikoi në zvogëlimin e gabimeve dhe lëshimeve për periudhën janar-mars të vitit 2021 për 3,7 milionë euro.





**Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Drejtoria për Statistikë**

Informacione shoqëruese:

Seritë kohore të të dhënave: vjetore, tremujore dhe mujore për bilancin e pagesave
http://www.nbrm.mk/platen_bilans.nsp

Shpjegime metodologjike:
https://www.nbrm.mk/platen_bilans.nsp

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimi të të dhënave
http://nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_na_objavuvanje_podatoci.pdf

Bilanci tremujor i pagesave: 30 nëntor, viti 2021 (mesatare referuese me shtatorin e vitit 2021).

Për pyetje gazetarësh, ju lutemi kontaktoni me personat e Kabinetit të Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme lidhur me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02 3215 181 lokali 103 (ose 110/108).